



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2021

**VENDIM**

**Nr. 76, datë 04.03.2021**

**PËR**

**PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E  
APELIT VLORË, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË  
SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 186, DATË 28.05.2020, PËR KANDIDATIN Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 2, të nenit 64, të Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 6, Seksioni B, Kreu V, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pasi shqyrtoi kërkesën e kandidatit për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Vlorë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 186, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbi propozimin e relatores së çështjes,

**VENDOSI:**

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Vlorë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 186, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**